



# Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

## Në këtë numër:


- Anëtarët e RrGGK Mësojnë Metoda të Hulumtimit.....2
- Partners Kosova avokon për të drejtat e grave në pronë.....2
- OPDMK kërkon të drejta për personat në karrige me rrota .... 3
- Gjykata dënon kryerësit e dhunës seksuale ..... 3
- Qendra për Mirëqenien e Gruas i bashkohet WAVE në Vienë.....3
- Gra nga 15 Komuna bëjnë strategji për avokim..... 4
- Studentët nga Universiteti Essex vizitojnë RrGGK..... 4
- CLE prezanton raportin barazia gjinore në biznes ..... 5
- Partnerët e Kvinna till Kvinna Diskutojnë mbi Praktikrat e Mira ..... 5

 Faqja në Facebook

 Lista për dërgesat e E-lajmeve

## Kosova i bashkohet Samitit Global për të Ndalur Dhunën Seksuale në Konflikte

Samiti Global për të ndaluar dhunën seksuale në konflikte me moton #kohapërveprim (#TimetoAct) është organizuar nga Sekretari i Jashtëm Britanik, z. Wiliam Hague dhe Përfaqësuesja e Veçantë e Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët znj. Angelina Jolie, në Londër nga 10 deri me 13 qershor. Presidentja e Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga mori pjesë në këtë Samit. Gjatë kësaj kohe nën patronatin e Presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, respektivisht nën patronatin e Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës me përkrahjen e Ambasadës së Britanisë së Madhe organizuan një varg aktivitete për shënimin e Samitit Global për të Ndalur Dhunën Seksuale në Konflikte. Me 11 qershor event i në kuadër të #KohapërVeprim u organizua tek Sahat Kulla në Prishtinë ku folën znj. Igballe Rogova, përfaqësuese e Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë luftës, z. Ian Cliff Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar dhe përfaqësuesja nga World Vision. Në fund të aktivitetit me anë të dritave në Sahat Kullë u ndriqua thënia #TimetoAct. (#KohapërVeprim).



#TimetoAct te Sahat Kulla,  
11 Korrik, Prishtinë

“Numri i saktë i njerëzve të dhunuar gjatë luftës mund të mos mësohet kurrë, por dihet se diku rreth 20.000 gra dhe vajza kanë përjetuar dhunë seksuale,” tha Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e RrGGK. “Edhe pse procesi i mbledhjes së fakteve dhe dëshmive është proces goxha i dhimbshëm, në të njëjtën kohë është proces fitimtar sepse më në fund është thyer heshtja dhe po bëhen aktivitete në nivel shumë të lartë.”

Ndër aktivitetet e organizuara në Prishtinë ishte poashtu edhe event i mbajtur në Sheshin 21, ku u shfaqën mesazhet nga Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës; Wiliam Hague, Sekretar i Jashtëm Britanik; Angelina Jolie, Përfaqësuese e Veçantë e Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara.

Vlora Çitaku, Ministre e Integritimit Evropian hapi ngjarjen, ndërkaq Tracy Ann Jacobson, Ambasadore e Shteteve të Bashkuara; Stafi i RrGGK-së dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve dhe organizatave ishin prezent.

Fushata #KohapërVeprim është pjesë e një iniciative globale për t'i dhënë fund dhunës seksuale. Në Konferencën e Londrës, është lancuar [Protokolli Global në Dokumentacionin dhe Hetimin e Dhunës Seksuale në Konflikt](#).

## Anëtarët e RrGGK Mësojnë Metoda të Hulumtimit

Me 9 qershor, RrGGK organizoi punëtorinë e titulluar “Bërja e Hulumtimit: Metodat Sasiore dhe Cilësore.”

Nicole Farnsworth, Menaxhere e Programeve në RrGGK, e cila mban titullin MA në Hulumtime të Sociologjisë, ofroi informacione lidhur me dallimin në mes të metodave sasiore dhe cilësore të hulumtimit; se si të përzgjedhet mostra e popullsisë së anketës; mostra e ndryshueshme në hulumtimin cilësorë; si të bëhen pyetje të mira; teknikat e intervistimit; dhe etikën e hulumtimit.

Pastaj, 21 anëtarët pjesëmarrëse diskutuan shembuj specifik të iniciativave të ardhshme të hulumtimit të anëtareve të RrGGK-së. [Shqiponjat e Dardanes](#) nga Graçanica dhe [Femrat Aktive të Gjakovës](#) nga Gjakova, kanë marrë grante përmes Fondit të Gravë të Kosovës (FGK) dhe në iniciativat e tyre përfshijnë bërjen e hulumtimit. Iniciativat e tyre ofruan shembuj konkret të dallimit në mes të bërjes së hulumtimit sasiore dhe cilësore.

Shqiponjat e Dardanes do të bëjë hulumtimin sasiore lidhur me pozitën e grave brenda komunës. Femrat Aktive të Gjakovës do të bëjë hulumtimin cilësorë lidhur me “Implementimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje”. “Edhe pse kam marrë pjesë në punëtori të ngjashme më herët, kjo ishte një përfitim shumë i mirë i informatave dhe na ndihmoi që të freskojmë kujtesën tonë,” tha Valbona Rizvanolli nga Femrat Aktive të Gjakovës. “Kjo punëtori poashtu është shumë e nevojshme, sepse do të ndihmojë OJQ-në tonë të kryej hulumtimin i cili po realizohet me përkrahje të Fondit të Grave të Kosovës.”

Materialet e përdorura në këtë punëtori mund t'i gjeni [online](#).

## Partners Kosova avokon për të drejtat e grave në pronë

[Partners Kosova \(PK\)](#) ka ftuar jo vetëm gra, por edhe burra në prezantimin e saj një ditë me temë “Të drejtat e grave në ndarjen e pronës dhe në trashëgimi” në komunën e Lipjanit me 28 maj. Në këtë prezantim gjithashtu morri pjesë edhe Zyrtari Komunal për Barazi Gjinore.

“Ndërsa avokojmë për këtë temë, do të duhet të punojmë për ta rritur vetëdijësimin në mesin e të dyja gjinive, dhe në mesin e njerëzve të moshave dhe mjediseve të ndryshme shoqërore,” ka thënë Hilmije Ramabaja, Menaxhere e Programit për Trajnime, Ndërmjetëse dhe Trajnuese pranë PK-së. “Vetëm në këtë mënyrë do të jemi në gjendje të mbërrijmë tek sa më shumë njerëz që të jetë e mundur dhe ta ndryshojmë mendësinë patriarkale, e cila ua mohon grave këtë të drejtë themelore.”

PK-ja planifikon të organizojë prezantime të ngjashme në tri komuna të tjera: Skënderaj, Drenas dhe Ferizaj. Më pas, grupet do të avokojnë më tej për këtë temë gjatë një mbledhje të dytë në secilën komunë, ku përfaqësuesit e institucioneve dhe palët e tjera të interesuara do ta diskutojnë çështjen. “Më ka pëlqyer shumë kjo ide dhe do të sugjeroj që diskutimi për këtë temë të zgjerohet sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që të ketë harmoni midis kornizës aktuale ligjore dhe aspektit praktik,” ka thënë Gafurr Ademi, Zyrtar për Çështjet Ligjore dhe Pronë në zyrën e kryetarit të komunës. “Në rrethanat ku ndodhet shoqëria jonë, është shumë e rëndësishme që edhe burrat të jenë të pranishëm kur diskutohen tema të tilla me qëllim që të rritet vetëdijësimi.”

Kjo nismë është mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (FGK) i RrGGK-së, i financuar nga Kvinna till Kvinna (KtK).



RrGGK organizoi “organizoi punëtorinë e titulluar “Bërja e Hulumtimit: Metodat Sasiore dhe Cilësore.” me 9 qershor.



Femrat dhe meshkujt diskutojnë për temën “Të drejtat e grave në ndarjen e pasurisë dhe të drejtat e trashëgimit” në prezantimin e organizuar nga Partners Kosova më datën 28 maj në Lipjan

## OPDMK kërkon të drejta për personat në karrige me rrota

Dy vullnetarë shtynë një karrige me rrota, të zbrazët, deri në majën e kodrës së kështjellës së lashtë të Prizrenit, duke simbolizuar në këtë mënyrë zhgënjimin e personave me distrofi muskulare, të cilët nuk mund ta bëjnë këtë udhëtim. Ky ishte njëri prej aktiviteteve të shumta që janë organizuar për të festuar javën e personave me distrofi muskulare.

Këtë vit, [Organizata për Personat me Distrofi Muskulare të Kosovës \(OPDMK\)](#), është përqendruar në mbështetjen e pamjaftueshme nga institucionet publike. Vetëm Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (financuar nga [ADA](#)) e kanë mbështetur në aspektin financiar organizatën gjatë dy viteve të fundit.

Ata kanë lëshuar balona me ngjyra të ndryshme në qiellin e kaltër. Secila balonë kishte emrin e një institucioni i cili do të duhet të punojë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Balonat janë lëshuar në të njëjtën kohë nga kështjella dhe nga qendra e qytetit.

“Për gjashtë ditë, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, do të ngremë zërin dhe do t’i tregojmë problemet, nevojat dhe shqetësimet tona, si dhe do t’i zgjidhim në të dyja nivelet: në atë lokal dhe qendror,” ka thënë Antigona Shestan nga OPDMK. “E mira është që ky projekt është në vazhdimësi të asaj që kemi bërë vitin e kaluar përmes projektit tonë, i cili është mbështetur nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, ku kemi arritur të shenjojmë 27 nga rreth 50 pika qasjeje në ndërtesat publike për personat me distrofi muskulore. Kjo është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit me Departamentin e Shërbimeve Publike të komunës tonë.”

Më 27 maj, ata e kanë dekoruar edhe një lule të bukur me letra shumëngjyrëshe, ku secila shprehte një nevojë, sfidë apo problem me të cilët ndeshen personat me distrofi muskulare. Ata hapën një çadër ku së bashku me vullnetarët kanë shpërndarë fletëpalosje për të drejtat dhe kërkesat e personave me distrofi muskulare. Ata kanë performuar edhe një dramë të shkurtër, me anën e së cilës kanë shprehur problemet me të cilat përballen në jetën e tyre të përditshme.

“Mungesa e zbatimit të disa urdhërësive administrative dhe ligjeve përsa i takon qasjes teknike në ndërtesat publike, e bën të vështirë qasjen për njerëzit me aftësi të kufizuara, ndërkohë që këto probleme nuk janë duke u zgjidhur,” ka thënë Gëzim Abazi nga Handicap Kosova. “OJQ-të, dhe në veçanti Handicap Kosova, tashmë nuk po kërkojnë vetëm zbatimin e këtyre ligjeve, por gjithashtu po kërkojnë edhe të verifikojnë se kush nuk po i zbaton ato, me qëllim që ata njerëz të gjobiten.”

OPDMK gjithashtu do të dorëzojë një dokument në të cilin detajohen të drejtat dhe kërkesat e tyre, dhe ku identifikohen pikat e tjera të qasjes në ndërtesat publike, të cilat duhet të rregullohen nga institucionet përgjegjëse për zgjidhjen e këtyre problemeve.



OPDMK kërkon të drejta për personat në karrige me rrota Pziren 27 Maj.

## Qendra për Mirëqenien e Gruas i bashkohet WAVE në Vienë

Koalicioni i Strehimoreve në Kosovë i'u bashkua Grave Kundër Dhunës Europë ([Women Against Violence Europe - WAVE](#)) në vitin 2011. Qendra për Mirëqenien e Gruas në Pejë, anëtare e RrGGK-së, është përfaqësuese brenda WAVE, që sjellë së bashku 48 organizata nga tërë Europa në një rrjet për ta luftuar dhunën.

Ardita Ramizi Bala nga [Qendra për Mirëqenien e Gruas](#) ka marrë pjesë në mbledhjen e nëntë në Vienë, me 26 dhe 27 maj 2014, për të ndarë informatat rreth statutit, bordit dhe asamblesë së re.

## Gjykata dënon kryerësit e dhunës seksuale

Sipas [Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës \(QKRMT\)](#), Gjykata e Apelit në Prishtinë ka nxjerrë një aktgjykim sipas të cilit janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar dy persona për akte kriminale dhe dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë. Ata janë ndëshkuar me 22 vite burgim.

Ky është sinjal pozitiv dhe inkurajues për organet e drejtësisë që të vazhdojnë ndjekjen dhe ndëshkimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë.

QKRMT ka ndarë këtë informatë si pjesë e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në mbështetje të viktimave të torturës me 26 qershor.

## Gra nga 15 Komuna bëjnë strategji për avokim

Grupet e Avokimit të Grave (GAG) nga 15 komuna të ndryshme morën pjesë në punëtorinë e dytë, "Gratë Avokojnë në Nivel Lokal dhe Qendror", e cila u mbajt me 26 dhe 27 qershor në hotel Arxhena, në malet e bukura të Brodit, në Dragash. GAG mbledhi gra nga asambltet komunale dhe anëtare të RrGGK-së për të bërë një strategji të përbashkët drejt barazisë gjinore në nivel lokal.

Në sesionin e parë të moderuar nga Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive në RrGGK, pjesëmarrëset raportuan për statusin e kampanjave të avokimit të tyre të përbashkët në komunat e tyre përkatëse. Kampanjat targetuan çështjet të cilat ato i kishin ngritur gjatë takimit të kaluar në Durrës.

Edhe pse anëtares të GAG-ut kanë planifikuar të arrijnë qëllimet e tyre avokuese në fund të vitit 2014, shumica e komunave këtë e kanë përfunduar në fund të qershorit.

"Është shumë mirë që ne kemi arritur ti realizojmë përpjekjet tona avokuese më herët se që kemi planifikuar. Por kjo nuk do të thotë që ne nuk do të identifikojmë çështje tjera për të avokuar për to në pjesën e mbetur të vitit," tha njëra nga pjesëmarrëset.

Punëtorija përfshiu dy sesione, të udhëhequra nga trajnerja inspiruese Shqipe Malushi, përfshirë "Fuqizimi dhe Mendimi Pozitiv - nga e pamundura në realizim".

"Ky sesion ishte shumë i nevojshëm dhe i dobishëm për ne," tha një pjesëmarrëse. "Duke marrë parasysh rutinën dhe sfidat me të cilat ne përballemi çdo ditë, definitivisht patëm nevojë që dikush të na kujtoj "të kthehemi mbrapa", të bëhemi pozitive dhe të na demonstroj teknika të dobishme për ta bërë këtë."

Dita e dytë e punëtorisë filloi me një sesion për buxhetimin drejt mirëqenies sociale, të udhëhequr nga Nicole Farnsworth, Menaxhere e Progamit në RrGGK. Ajo ndau një metodë shumë të thjeshtë për buxhetimin drejt mirëqenies sociale që RrGGK ka përdorur në një bashkëpunim me Komunën e Kamenicës dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).

"Ne të gjithë pajtohemi që fakti se Qarkorja Buxhetore 2015/01 për Komunitet inkurajon buxhetimin gjinor është lajm i mirë", tha një pjesëmarrëse. "Tani ne do të përdorim treguesit nga një perspektivë gjinore për të matur ndikimin e buxhetit mbi jetën e grave dhe burrave."

Gjatë sesionit të fundit të udhëhequr nga Igballe Rogova, pjesëmarrëset planifikuan hapat e ardhshëm për GAG. Mbështetja e GAG-ve është pjesë e arritjes së implemetimit të Planit Strategjik të RrGGK, që përmban qëllime të rëndësishme për të rritur përfshirjen e grave në politikë dhe vendim-marrje. RrGGK beson se pjesëmarrja aktive do të jetë e mundur vetëm përmes bashkëpunimit dhe avokimit të përbashkët për çështjet që gratë i cilësojnë të rëndësishme në nivel lokal dhe kombëtar.

Ky aktivitet është mbështetur nga Austrian Development Agency (ADA).

GAG bashkojnë gratë nga politika dhe gratë nga shoqëria civile në përpjekje për të avokuar për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore në nivel lokal.

## Studentët nga Universiteti Essex vizitojnë RrGGK

Studentët nga Universiteti Essex që studiojnë në Qendrën e të Drejtave të Njeriut, vizituan RrGGK-në me 16 Qershor. Ata shfaqën interesim që të mësojnë më shumë për përvojat e aktivisteve për të drejtat e grave në Kosovë, zhvillimet e fundit dhe sfidat për të drejtat e njeriut, si dhe për pengesat e mundësitë në të ardhmen.

Menaxherja e Programit dhe Hulumtuesja Nicole Farnsworth, informoi studentët për punën e RrGGK, historinë e lëvizjes së grave në Kosovë, si dhe për Raportin mbi Monitorimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 në Kosovë.

Pas këtij prezentimi, studentët patën mundësinë të bëjnë pyetje të ndryshme. "Ky ka qenë njëri ndër takimet më të mira që kam marrë pjesë ndonjëherë. Ju bëtë një prezantim të shkëlqyeshëm dhe ne u njdemë të lirë të bëjmë çfarëdo pyetje që donim", tha njëri nga pjesëmarrësit në takim.



Grupet e Avokimit të Grave (GAG) nga 15 komuna të ndryshme morën pjesë në punëtorinë e dytë 26-27 Brod, Dragash

## CLE prezanton raportin barazia gjinore në biznes

Programi për Përmbardim dhe Legjislacion Komercial (CLE) ka prezantuar raportin [Barazia Gjinore në Biznes](#) me 3 qershor në Prishtinë, Raporti i Programit për Përmbardim dhe Legjislacion Komercial (CLE) për Barazinë Gjinore në Biznes, është një shembull se si politikat dhe strategjitë gjinore të USAID-it përkthehen në veprime në “botën reale”.

Raporti trajton përceptimet publike për barrierat me të cilat përballen gratë në ambientin ekonomik dhe ligjor.

Përkundër të gjitha provave që dëshmojnë se fuqizimi i grave është politikë e mençur ekonomike, gratë shpesh gjenden në pozitë të pafavorshme sa i përket mundësive ekonomike, siç janë punësimi, trajnimi dhe edukimi, qasja në financa dhe posedimi i pronës.

Në Kosovë, statistikat tregojnë që shkalla e papunësisë së grave është 40%; gratë përbëjnë 0.3% të menaxhereve të lartë në kompanitë private; gratë përbëjnë vetëm 11% të pronareve të bizneseve të vogla; vetëm 8% e grave janë pronare tokash. Kufizimet për pjesëmarrjen aktive të grave në ekonomi përfshijnë aplikimin dhe zbatimin në nivel të ulët të ligjeve dhe politikave kundër diskriminimit, si dhe stereotipet e fuqishme gjinore të pranuar gjerësisht nga shoqëria.

“Përpjekjet për ta fuqizuar ekonomikisht gruan, janë përpjekje për të treguar jo vetëm nivelin e demokratizimit të shoqërisë, por mbi të gjitha, për ta orientuar vendin drejt një zhvillimi më të drejtë dhe më të hovshëm ekonomik. Fuqizimi ekonomik i gruas është fuqizim i shoqërisë në tërësi, është investim në të ardhmen dhe garantues i prosperitetit të vendit,” tha Presidentja Jahjaga. “Thellësisht jam e bindur se fuqizimi ekonomik i grave, do të na sjellë fuqizimin e tyre në politikë dhe vendimmarrje, aty ku çdo ditë vendoset për fatin e fëmijëve tanë, për të ardhmen e vendit por edhe më gjerë.”

Të gjetuarat nga ky raport do të ndihmojnë Programin për Përmbardim dhe Legjislacion Komercial (CLE) dhe programet e tjera të USAID-it për të zhvilluar aktivitetet e ardhshme duke e kuptuar më mirë se si të adresojnë dallimet reale dhe të perceptuara gjinore të pjesëmarrjes në ekonomi.



Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga flet në prezantimin e raportit Barazia Gjinore në Biznes, organizuar nga CLE me 3 qershor në Prishtinë.

## Partnerët e Kvinna till Kvinna Diskutojnë mbi Praktikën e Mira

[Kvinna till Kvinna \(KtK\)](#) ka organizuar konferencë mbi Praktikën e Mira për partnerët e saj nga Ballkani Perëndimor në Hotel Bleart në Durrës, Shqipëri nga 24-27 qershor. Qëllimi i konferencës ishte ndarja e përvojave dhe praktikave të mira, si dhe t'u ipet hapësira për rrjetëzim aktivisteve për të drejtat e grave.

Konferenca përfshinte një numër punëtorish me tema të ndryshme mbi qështje me interes dhe sfida, si në vazhdim: *Puna me gratë në politikë* – përvoja nga rajoni; *1325 Plani Kombëtar i Veprimit* – marrja e kontrollit dhe përgjegjësisë; *Arti si mjet për ndryshime sociale*; *Avokimi i BE-së* – këshilla të mira dhe shembuj praktik; *Aktivistet e Reja në udhëheqje*, *Puna kundër Dhunës ndaj Grave (Violence against Women - VAW) në nivel kombëtar dhe lokal* – përvoja nga rajoni; dhe *Mbrojtësit e të Drejtave të Grave* – puna me udhëzimet e BE-së dhe rezolutat e OKB-së.

Lena Ag, Sekretare Gjenerale në Kvinna till Kvinna, bëri hapjen e konferencës, duke ofruar kështu informata lidhur me planin e tanishme dhe afatgjatë të KtK-së për rajonin e përtej. Ajo citoi Virginia Wolf, “Si grua, nuk kam shtet. Shteti im është e gjithë bota.”

Stafi i RrGGK-së ishte pjesë e panelit: Nicole Farnsworth, Menaxhere e Programit, foli për përpjekjet e RrGGK-së për monitorimin dhe avokimin e implementimit të RKSKB 1325; ndërsa Mimoza Paçuku, Kordinatore e Fondit të Grave të Kosovës, prezantoi në panelin e Aktivisteve të Reja në Udhëheqje. Gjithashtu, anëtarët e RrGGK nga organizatat Legjenda; Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut; dhe Aureola ndanë përvoja të tyre me të pranishmit.



Kvinna till Kvinna bashkoi organizatat partnere në konferencën Praktikën e mira. 24-27 qershor.  
Foto nga Yllka Soba Kvinna till Kvinna.